

ARTIKULLI #10

UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS AVANSOJNË AFTËSITË DHE PRAKTIKAT E TYRE

për Rishikimin e Kurrikulës për t'u Përshtatur me Trendet dhe Sfidat e Industrisë

NOVEMBER 30, 2023

Për më shumë foto mbi këtë artikull, shkoni në link:

<https://drive.google.com/drive/folders/1YT6R65fSiF4lebQsh92w0IhzUUkYfZGG>



Figura 1: Sesion trajnimi për udhëheqje të paneleve korporative për rishikim të kurrikulave

Universitetet publike të Kosovës po përmirësojnë bashkëpunimin e tyre me liderë të industrisë në sektorët e Bujqësisë dhe TIK-ut, për të harmonizuar rishikimet e kurrikulës që të përshtaten me kërkesat e tregut. Duke filluar nga ky Nëntor, stafi akademik i universiteteve, qendrat për ekselencë në mësimdhënie, dhe qendrat për karrierë të studentëve janë duke kaluar nëpër trajnime për të udhëhequr grupe pune, të përkushtuara për adaptim dhe përmirësim të vazhdueshëm të kurrikulës, për të përmbushur kërkesat më të fundit të tregut të punës. Znj. Monica Rossi, Eksperte e Edukimit të Bazuar në Kompetencë nga Universiteti i Iowa, udhëheq sesione trajnimi të cilat bazohen në eksertizën e bashkëpunimit akademi-industri për të adresuar kërkesat për trajnime dhe arsimim të universiteteve partnere në Kosovë.

Këto sesione janë pjesë e Programeve të Trajnimit të Trajnerëve, të mundësuar me mbështetje nga USAID Kosova, dhe janë dizajnuar dhe ofruar nga Universiteti i Iowa nën Aktivitetin Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë. Ky aktivitet është mbështetur nga USAID dhe i zbatuar nga Universiteti i Iowa në partneritet me Universitetin Shtetëror të Iowa dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). Synimi është që të prodhohen trajnerë të aftësuar të cilët do të udhëheqin panele korporative universitet-industri në të ardhmën. Këto panele, të cilat përbëhen nga përfaqësues të universiteteve dhe profesionistë të industrisë, krijojnë dhe

rishikojnë programe studimi, duke i harmonizuar ato përmes këshillave nga figura të suksesshme të industries, të cilët punojnë drejtpërdrejt në fushë.



Figura 2: Ushtrim grupor mbi kryerjen e analizës së punës për rishikim të kurrikulës

Tashmë janë mbajtur katër sesione trajnimi në Universitetet partnere të aktivitetit, duke përfshirë Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Pejës, dhe Universitetin e Prizrenit. Me mbi 40 pjesëmarrës, këto sesione kanë ofruar një mundësi të shkëlqyeshme për të vlerësuar praktikat aktuale të universiteteve të cilat ndërlidhen me zhvillim të kurrikulës në bashkëpunim me sektorin privat. Pjesëmarrësit u thelluan në metoda për forcimin e angazhimit të profesionistëve të industrisë, strukturimin efektiv dhe udhëheqjen e paneleve korporative, duke siguruar përfshirje të ekspertëve me kualifikime të larta të industrisë, dhe identifikimin e kompetencave dhe kërkesave për trajnime për programet e synuara të studimit të universiteteve.

Kjo shënon serinë fillestare të trajnimeve të liderëve të paneleve korporative, me të tjera të cilat do të vazhdojnë përgjatë pesë viteve të ardhshme. Disa nga pjesëmarrësit ndajnë mendimet e tyre mbi përvojën e tyre:

"Adaptimi dhe zhvillimi i programeve tona të studimit për t'u përputhur me kërkesat e industrisë është një hap thelbësor drejt arritjes së akreditimit. Ne e vlerësojmë shumë mbështetjen dhe udhëzimin e ofruar nga Universiteti i Iowa për udhëheqjen e paneleve korporative. Kjo përvojë na ka shërbyer një mundësi të vlefshme për të forcuar aftësinë tonë që të analizojmë kërkesat e tregut të punës, të angazhohemi në diskutime domethënëse, dhe të vlerësojmë metodat tona të rishikimit të kurrikulës së bashku me kolegët tanë nga universitete të ndryshme. Për më shumë, ne kemi përfituar vegla të cilat na ndihmojnë të mbledhim informata esenciale dhe të angazhohemi me përfaqësues të industrisë, të cilët luajnë një rol vital në formësimin e iniciativave tona arsimore." –Asst. Prof. Zana Limani Fazliu, Fakulteti i Shkencave Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës.



Figura 3: Prezantim nga pjesëmarrësit në sesionin e trajnimit

Dedikimi dhe përkushtimi i universiteteve publike të Kosovës për të adaptuar dhe zhvilluar kurrikulën e tyre, për të përmbushur kërkesat e industrisë, janë një shtytje e rëndësishme drejt arritjes së akreditimit dhe sigurimit të punësueshmërisë së të diplomuarëve të tyre. Udhëzimi dhe bashkëpunimi me Universitetin e Iowa, së bashku me ekspertë nga industria, kanë dëshmuar të jenë jashtëzakonisht të vlefshme në këtë rrugëtim. Aftësitë, njohuritë, dhe veglat e fituara përmes këtyre sesioneve të trajnimit padyshim do të luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e të ardhmës së arsimit në Kosovë dhe fuqizimin e studentëve me njohuri dhe aftësi që kërkohen për një karrierë të suksesshme në tregun dinamik të punës.